



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 11321 Prot

Vlorë, më 11.07.2025

Lënda: Informacion mbi raportin statistikor të punës dhe vendimmarrjes së Këshillit të Bashkisë Vlorë, për periudhën 1 Janar- 30 Qershor 2025.

Para Këshillit të Bashkisë

Të nderuar këshilltarë

Informacioni mbi punën, aktivitetet dhe vendimmarrjen e Këshillit të Bashkisë që i paraqitet Këshillit të Bashkisë, periodikisht është jo vetëm si detyrim bazuar në rregulloren, “Per organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Bashkisë”, neni 111, por veçanërisht merr rëndësi në kuadër të parimit të transparencës që duhet të karakterizojë aktivitetin dhe vendimmarrjen e këtij Këshilli.

Në një vështrim të përgjithshëm në periudhën raportuese gjashtë mujore, puna e Këshillit të Bashkisë, ka synuar që nëpërmjet vendimmarrjes përkatëse të jetë në funksion të plotësimit të interesave të komunitetit referuar dispozitave ligjore në fuqi. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 Këshilli i Bashkisë Vlorë, ka zhvilluar shtatë mbledhje nga të cilat një mbledhje jashtë rradhe, e cila u zhvillua në respektim të afateve për trajtimin e familjeve të dëmtuara nga situata e shirave të vitit 2024 duke patur parasysh ndalesat ligjore, që krijoheshin nga zgjedhjet e datës 11 Maj.

Në këto mbledhje të këshillit janë miratuar 61 vendime, të cilat sipas objektit janë si më poshtë:

-Për ndihmën ekonomike 14 vendime.

-Për emergjencat civile:10 vendime.

-Për emertimin e rrugeve dhe vlerësimin e personaliteteve të shquara: 8 vendime.

-Për strehimin dhe shërbimet:7 vendim.

-Për Buxhetin dhe ndryshimet në Buxhet :7 vendime si dhe ndërkohë dhe 15 vendime të tjera me objekt të ndryshëm si: nënshkrim të kontratave ose akt marrveshjeve, çështjeve të pronësisë etj.

E rëndësishme është të theksohet që shumica e vendimeve të Këshillit, veçanërisht ato të Ndihmës Ekonomike, të Emergjencave Civile, rastet e Emërtimit të Rrugëve dhe vlerësimit

të personaliteteve të shquara janë miratuar nga këshilltarët pothuaj unanimitisht, pavarësisht grupimit politik që përfaqësojnë.

Ndërkohë, ka pasur vendime veçanërisht ato që lidhen me çështje të pronësisë të ndryshimeve në Buxhet etj, të cilat janë votuar nga shumica e këshilltarëve, por që gjatë diskutimeve në Këshill por edhe në procesin e vendimmarrjes është shprehur edhe qëndrimi sipas përfaqësimit politik.

Në varësi të objektit të projektvendimve të paraqitura nga administrata e Bashkisë për miratim në Këshillin e Bashkisë, nga Kryesia e Këshillit janë planifikuar edhe mbledhjet e komisioneve të përcaktuara të Këshillit. Kjo në zbatim të procedurave të parashikuara në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Bashkisë.

Gjatë kësaj periudhe janë planifikuar të zhvillohen 24 mbledhje të komisioneve të përhershme, ku dominojnë Mbledhjet e Komisioneve, Komisionit Juridik dhe atij të Financës, të cilët janë mbledhur rregullisht para çdo mbledhje të Këshillit. Ndërkohë, komisionet e tjera janë kërkuar të mbledhen në varësi të objektit të akteve të parashikuara për t'u shqyrtuar nga Këshilli i Bashkisë.

Është për t'u përmendur fakti se gjatë kësaj periudhe raportuese, për shkak të mos plotësimit të kuorumit të kërkuar një mbledhje e Këshillit, ajo e muajit prill, nuk u zhvillua në datën e caktuar por u shty për një ditë tjetër. Gjithashtu, për mungesë kuorumi në gjashtë raste nuk u zhvilluan mbledhjet në komisionet e përhershme, si problem shqetësues mbetet fakti që nga anëtarët e Këshillit, të komisioneve të përkohshme duhet vlerësuar pjesëmarrja në mbledhjet e komisioneve por edhe në mbledhjet e Këshillit, me qëllim që këto mbledhje të zhvillohen normalisht dhe të respektohen procedurat e kërkuara në funksion të mbledhjes së Këshillit.

Duhet theksuar që në tërësi marrëdhëniet e administratës së Bashkisë me Këshillin e Bashkisë, kanë qënë në frymën e bashkëpunimit në funksion të vendimmarrjeve sa më ligjore dhe në shërbim të komunitetit. Kjo ka bërë që të gjitha vendimet e miratuara nga Këshilli i Bashkisë, të jenë dakortësuar paraprakisht dhe të jenë vlerësuar si të lingjshëm nga prefekti i Qarkut Vlorë. Pavarësisht kësaj mbetet për tu përmirësuar nga administrata, çështja e respektimit të afateve procedurale në përgatitjen e projektakteve për miratim, si dhe mundësia e shmangieve të rasteve të emergjencës së tyre në mbledhjet e radhës të Këshillit. Kjo me qëllim që edhe Këshilli i Bashkisë, të ketë mundësi të respektoj procedurat përkatëse ligjore gjatë vendimmarrjes. Veçanërisht kjo është e domozdoshme në rastet e projektakteve për të cilat është i detyrueshëm konsultimi publik.

Një rëndësi e veçantë në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë i është kushtuar problematikave të ngritura nga qytetarët ose nga vetë këshilltarët, të cilat janë diskutuar në një pikë të veçantë të rendit të ditës. Krahas informacionit të marrë prej punonjësve të administratës së Bashkisë, gjatë mbledhjes kërkesat për informacion janë përcjellë zyrtarisht me shkresë nga sekretariati i këshillit, administratës së Bashkisë. Lidhur me kërkesë/ankesat e qytetarëve ose të Këshilltarëve duhet një angazhim me i madh nga administrata e Bashkisë (drejtoritë përkatëse) të cilat jo vetëm kanë detyrimin të japin informacionin e kërkuar në afat por edhe të marrin masa për zgjidhjen e problematikave të cilat në të shumtën e rasteve lidhen me infrastrukturën dhe shërbimet publike. Rëndësi duhet kushtuar gjithashtu edhe analizave e informacioneve të cilat janë parashikuar në programin vjetor të punës së Këshillit për të cilat administrata e Bashkisë, në disa raste e vonon ose në raste të tjera e jep të pa saktë informacionin e kërkuar.

Konkretisht, gjatë periudhës gjashtë mujore në programin e punës së Këshillit të Bashkisë sipas muajve janë parashikuar 11 analiza pune ose informacione nga drejtoritë e Bashkisë ose institucionet e varësisë. Nga këto, janë përcjell në Këshillin e Bashkisë informacionet ose analizat e kërkuara vetëm nga shtatë prej tyre.

Nga ana e Këshillit të Bashkisë në kuadër të parimit të transparencës me publikun dhe institucionet, në vijimësi të gjitha aktivitetet e Këshillit, si dhe vendimmarrjet e tij janë transmetuar në mediat lokale dhe në Facebook. Gjithashtu, gjithashtu që lidhet me procedurat për mbledhjet e Këshillit të Bashkisë dhe vendimet përkatëse janë publikuar rregullisht në faqen zyrtare të Bashkisë. Për ta realizuar sa më mirë transparencën me publikun është bashkëpunuar me projektin “Bashki të Forta” nëpërmjet pjesëmarrjes së këshilltarëve në seminare, trajnime etj. Ndërkohë përfaqësues të këtij projekti kanë asistuar në mbledhjet e Këshillit të Bashkisë. Po kështu është bashkëpunuar edhe me projekte të tjera të organizuara nga shoqata të ndryshme si dhe janë njoftuar shoqatat që kanë aktivitet në qytetin e Vlorës për mbledhjet e Këshillit të Bashkisë. Nisur nga sa më lartë është e domosdoshme që lidhur me mangësitë e konstatuara anëtarët e këshillit në vijim të rrisin më shumë ndjenjën e përgjegjësisë për ti eliminuar ato. Gjithashtu sikurse u citua më lartë edhe administrata e Bashkisë duhet t’ju përgjigjet në kohë detyrimeve përkatëse në varësi të problematikave të konstatuara.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri

